Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Shtojca 11

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS³

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

³ Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Shtojca 12

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- dh. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- e. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- f. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- g. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)

2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

2.2.2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: _____ () lekë pa TVSH.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

2.2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje vertetim qe nuk ka detyrimee ndaj Bashkise Himare.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

2.3 Per kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

ose

- b.** punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është është jo më e vogel se dyfishi i fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.4 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.
 - Leje ndertimi

2.5 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

3.Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë profesionale të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P – 1 E (Punime gërmimi në tokë)
- N.P- 2 D (Ndertime Civile dhe industriale)
- N.P- 4 C (Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, trmvaji, metro, pista aeroportuale)
- N.P – 5 C (Punime nëntokësore, ura e vepra arti)
- N.P – 7 D (Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)
- N.P – 9 C (Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike e bonifikime)
- N.P – 12 E (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- N.S – 1 A (Punime per prishjen e ndërtimeve)
- N.S- 3 C (Impiante ngritese dhe transportues(ashensore, shkalle levizese, transportues))
- N.S – 14 A (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)
- N.S – 15 A (Pastrim i ujërave detare, liqenore dhe lumore)
- N.S – 16 C (Ndertim i impianteve te ujërave te pijshem dhe pastrimit te tij)
- N.S – 17 A (Ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane)
- N.S – 18 B (Punime topogjeodezike)
- N.S – 19 A (Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture)
- N.S – 20 B (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

5.Një punësim mesatar i të paktën 250 (dyqind e pesedhjetë) personave, për periudhën Janar - Shtator 2020 të vërtetuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar - Shtator 2020.
- b. List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar - Shtator 2020.

6.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar Staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------|---|
| 1. Inxhinier Ndertimi | 2 (dy) (ku një prej tyre të jetë profili Strukturist) |
| 2. Inxhinier Hidroteknik | 2 (dy) |
| 3. Inxhinier Topograf | 1 (një) |
| 4. Inxhinier Mjedisi | 1 (një). |
| 5. Inxhinier Mekanik | 1 (një). |
| 6. Inxhinier Elektrik | 1 (një). |

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

7. Inxhinier Gjeolog 1 (një)
8. Inxhinier elektronik 1 (nje)

Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Janar - Shtator 2020. Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë punë e noterizuar, Diploma, CV.

7. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme
- b) Diplomë, CV

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

8. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar - Shtator 2020, të shoqëruar me kontrate pune , diplome, stafin inxhinierik mbështetës si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (nje) Topograf
- 1 (nje) Inxhinier Pyjesh
- 1 (nje) Agronom

Për Stafin e sipërcituar të paraqitet, kontrate pune e vlefshme , diplome .

9. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar (nje) Inxhinier – Auditues energjie (i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjisë), duhet të ketë keto dokumenta provues: Kontrata e punës e vlefshme, Certifikata (Dip) për eficientësinë e energjisë. Duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar - Shtator 2020.

10. Operatori Ekonomik duhet të ketë në perberje të stafit Nje Mjek në perputhje të plote me VKM nr.108 date 09.02.2011, i ndryshuar, të vertetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni të leshuar nga Urdheri i Mjekut.

11. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar dy (dy) punonjës që të disponojnë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të shoqëruar me

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar - Shtator 2020..

12. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier i pajisur me certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të vërtetuar me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, kontratë pune të vlefshme, diplomë, i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar - Shtator 2020.

13. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 1 (një) Ekspert Zjarrfikës të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, leje për ushtrim profesioni për ekspert zjarrfikës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën Janar - Shtator 2020.

14. Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën Janar - Shtator 2020.

15. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje të Miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për “Depozitimin dhe sistemin e dherave dhe inerteve” brenda territorit të Bashkisë Himare. Ose të paraqesë Kontratë shërbimi për “Venddepozitimin e dherave dhe inerteve” brenda territorit të Bashkisë Himare.

16. Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitetet, kontratat e nevojshme mbi zbatimin e planit të menaxhimit të monumenteve të natyrës që ka lidhje me projektin, dhe autorizimet përkatëse

17. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar - Shtator 2020, si më poshtë:

- 2 teknik ndertimi
- 3 specialist ndertimi
- 4 hidraulik
- 4 mekanik
- 2 saldator
- 2 elektrikist
- 2 hekurkthyes
- 4 karpentier

18. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pese) punonjës manovratorë, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale të punës të vlefshme, Dëshmi

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, si dhe te figuroje ne lispagesat e shoqerise .

19. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 5 (pese) punonjes shofere, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, patenten perkatese, si dhe te figuroje ne lispagesat e shoqerise.

20. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licensat/Lejet e meposhtme:

- a. Liçense nga QKB me Kod 1.2.A. për Mbrojtjen nga Zjarri .
- b. Licence nga QKB me kod III.2.A (1+2) (per sherbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis).
- c. Licence nga QKB me Kod III.2. B “Për Grumbullim dhe Transportim i mbetjeve te parrezikshme inerte dherave”.
- d. Leje mjedisore lëshuar nga QKB Kodi III.1.A. “Per trajtimin e ujerave te zeza”
- e. Leje mjedisore lëshuar nga QKB Kodi III.1.A. “Për stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme”
- f. License lëshuar nga QKB Kodi III.2.B. “Transportim i ujrave te ndotura urbane, llumrave skeptike dhe ujrave te zeza”

21. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë :

- a) ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise)
- b) ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)
- c) ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune)
- d) ISO 3834-2:2006 (Kerkesat e cilesise per saldim me shkrirje te materialeve metalike)

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë perkatesisht Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

22. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

23. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 13).

Kamion v/shkarkues kapaciteti mbajtës mbi 20 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës deri 20	4 copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit
 “Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

ton		
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me Cekic	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	3 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavatore	4 cope	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncina kapaciteti mbajtës deri ne 5 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompa uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	3 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak	2 copë	Pronësi ose me qera
Pjaster vibruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere	4 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	3 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
Kontenier per zyra	2 cope	Pronësi ose me qera
Kulle ndricimi	2 cope	Pronësi ose me qera
Aparat per filtrimin e ujerave te zeza, me kapacitet mbi 5 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe per ujrart e zeza	2 cope	Pronësi ose me qera
Depozite Uji 5000 lit	2 cope	Pronësi ose me qera
Mini Dumper	1 cope	Pronësi ose me qera
Trencher	1 cope	Pronësi ose me qera
Impiante per thyerje dhe seleksionim materiale inertesh i pajisur me leje mjedisore	1 cope	<i>Në pronësi / qira /</i>
Fabrike Betoni i pajisur me leje mjedisore, jo me larg se 30 km nga objekti	1 cope	<i>Në pronësi qira/</i>
Fabrike Asfalti i pajisur me leje mjedisore, jo me larg se 30 km nga objekti	1 cope	<i>Në pronësi /qira/</i>

- a) Per mjetet me rrota qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin (Leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, leje transporti.
- b) Per mjetet me rrota qe shenohen ne regjistra publike qe merren me qira te paraqitet kontrata noteriale e qirase e vlefshme gjate gjithë afatit te realizimit te kontrates objekt prokurimi.

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

Bashkangjitur kontrates se qirase duhet te jene leja qarkullimit, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.

- c) *Per mjetet dhe pajisjet qe nuk pajisen me leje qarkullimi te paraqitet dokument i vlefshem qe verteton pronesine apo marrjen me qira te tij.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 13. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g) *Për fabrikën e betonit, nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet vendndodhja (ne distance teknikisht te pranueshme nga objekti jo me shume se 35 km, per te garantuar hedhjen ne veper brenda kushteve teknike), kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera duhet të paraqitet vendndodhja (ne distance teknikisht te pranueshme nga objekti jo me shume se 35 km, per te garantuar hedhjen ne veper brenda kushteve teknike krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases).*
- h) *Operatori ekonomik per fabrikën e asfaltit dhe te betonit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike (per fabrikën e betonit ne distance teknikisht te pranueshme nga objekti, per te garantuar hedhjen ne veper brenda kushteve teknike). Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.*

24. Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për materialet / pajisjet sipas tabelës së mëposhtme

Nr.	Emërtimi i materialeve / pajisjeve	Specifikimet teknike referuar katalogëve dhe nr. i faqes se katalogëve per çdo pajisje etj, testimet zyrtare	Kompania prodhuese	Certifikata ISO e Prodhuesit (9001:2008/2015) ose Certificate Komformiteti CE
1	Tubo PE 100			
2	Matës uji, instalimi horizontal, dial i thatë			
3	Rakorderi celiku dhe gize			

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori si dhe të japë një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike të pajisjeve të përfshira në skedën teknike,

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara. Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklaroj sipas pasqyrës së mësipërme, specifikimet teknike (referuar katalogëve dhe nr. i faqes se katalogëve per çdo pajisje / material etj.) kompaninë prodhuese dhe certifikatën ISO 9001:2008/2015 ose Certifikatën e Konformitetit CE të prodhuesit së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese, me qëllim verifikimin e origjinës së artikujve dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Katalogët së bashku me dokumentet e tjera duhet të paraqiten *në gjuhën shqipe ose angleze*. Me anë të kësaj skede teknike ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me ato të deklaruara në ofertë dhe të prodhuara nga kompani të çertifikuara sipas standardit ISO 9001:2008/2015.

Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë shërbimi noteriale me një laborator testimi të materialeve të ndertimit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizat e cmimeve për të gjitha zerat e preventivit si dhe plan – organizimi të punimeve, planin e menaxhimit të sigurisë dhe trafikut, planin e menaxhimit të mjedisit dhe metodologjinë e punimeve në objekt sipas kërkesave të përcaktuara nga KTP dhe KTZ në fuqi.

Do të organizohet një vizitë në kantier 3 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 10:00 pranë Autoritetit Kontraktor për të paraqitur mostrat e tubacioneve HDPE, me raport testimet përkatëse, si dhe shoqeruar me Certifikatat ISO të prodhimit, Operatori i interesuar Ekonomik Gjatë vizitës do t’u japin informacione shtesë e shpjegime ku dhe do të pajisen me vertetim nga insitucioni.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Shtojca 14

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkelidhur DST!

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Shtojca 15

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Shtojca 16

[Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Dokumenta Standarde të Tenderit
“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe
Palasë”

Shtojca 17

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
<i>(me numra dhe fjalë)</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
<i>(me numra dhe fjalë)</i>

Etj. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë”

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

